LIGJ
Nr. 58/2018

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (MARRËSI), PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË, DHE KfW FRANKFURT AM MAIN (KfW) PËR PROGRAMIN E REHABILITIMIT TË KONVIKTEVE TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, SIPAS PARIMIT TË EFICIENCËS SË ENERGJISË, FAZA II

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Marrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main (KfW) për financimin e programit të rehabilitimit të konvikteve të Universitetit të Tiranës, sipas parimit të eficiencës së energjisë, faza II, me një grant në shumën prej 2 032 179,23 (dy milionë e tridhjetë e dy mijë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë presje njëzet e tre) eurosh, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 20.9.2018

Shpallur me dekretin nr. 10892, datë 10.10.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

MARRËVESHJE FINANCIARE

DATË 19.12.2017, NDËRMJET KfW FRANKFURT AM MAIN (KfW) DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (MARRËSI), PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË, 2,032,179.23 EURO
- PROGRAMI I REHABILITIMIT TË KONVIKTEVE TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, SIPAS PARIMIT TË EFICIENCËS SË ENERGJISË, SHQIPËRI, FAZA II - BMZ-NR. 2016 67 526

Bazuar në marrëveshjen e datës 2 maj 2017, e cila ende nuk ka hyrë në fuqi, ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për bashkëpunimin financiar 2016, për projektin "Programi për rehabilitimin e konvikteve të Universitetit të Tiranës, sipas parimeve të eficiencës energjetikë, faza II" (Marrëveshje Qeveritare), Marrësi dhe KfW-ja bien dakord të lidhin këtë Marrëveshje Financiare.

Neni 1
Shuma dhe qëllimi i kontributit financiar

1.1 KfW do të japë një kontribut financiar për Marrësin në një vlerë që nuk kalon 2,032,179.23

euro.

Ky kontribut financiar nuk do të shlyhet, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në nenin 3.2.

1.2 Marrësi, i cili në këtë aspekt përfaqësohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ("Ministria Zbatuese e Programit" ose "MZP"), do të përdorë kontributin financiar ekskluzivisht për Rehabilitimin, sipas parimeve të eficiencës energjetike të konvikteve të Universitetit të Tiranës, faza II (Programi) dhe kryesisht për të financuar kostot e kursit të këmbimit. MZP-ja dhe KfW-ja do të përcaktojnë detajet e Programit, si dhe mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga kontributi financiar nëpërmjet një marrëveshjeje të veçantë për të cilën do të merret miratimi i Marrësit të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Marrëveshja e Veçantë).

1.3 Taksat dhe detyrimet e tjera publike që mund të krijohen nga Marrësi dhe taksat doganore për importet nuk duhet të financohen nga kontributi financiar.

Neni 2

Disbursimi

2.1 KfW-ja do të disbursojë kontributin financiar në përputhje me progresin e Programit dhe bazuar në kërkesën e Marrësit, e cila në këtë rast përfaqësohet nga MZP-ja. Nëpërmjet një marrëveshjeje të veçantë, e cila do të miratohet nga Marrësi, MZP-ja dhe KfW-ja do të përcaktojnë procedurat e disbursimit, në veçanti faktet që provojnë se fondet e kërkuara janë përdorur për qëllimin e përcaktuar.

2.2 KfW-ja ka të drejtë të refuzojë disbursimin e fondeve pas datës 30 dhjetor 2021 ose ndonjë datë tjetër për të cilën është rënë dakord ndërmjet dy palëve.

Neni 3

Pezullimi i disbursimeve dhe shlyerja

3.1 KfW-ja nuk mund të pezullojë disbursimet, me përjashtim të rasteve, kur:

a) Marrësi nuk mund të përmbushë detyrimet e tij ndaj KfW-së për të kryer pagesat brenda afatit;

b) Janë shkelur detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje ose sipas marrëveshjeve të veçanta që lidhet me këtë Marrëveshje;

c) Marrësi, nëpërmjet MZP-së, nuk është i aftë të provojë se të gjitha shumat e disbursuara janë përdorur për qëllimin e caktuar;

d) Përmbushja e detyrimeve të KfW-së sipas kësaj Marrëveshjeje bie ndesh me ligjin e zbatueshëm; ose

e) Krijohen rrethana të jashtëzakonshme, të cilat pengojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e Programit.

3.2 Nëse ka ndodhur ndonjë nga situatat e përcaktuara në nenin 3.1(b), (c) ose (d) dhe nuk është arritur të eliminohen brenda një afati kohor të përcaktuar nga KfW-ja, që megjithatë, duhet të jetë të paktën 30 ditë, KfW-ja mund të:

a) Kërkojë shlyerjen e menjëhershme të të gjitha shumave të disbursuara në rastin e parashikuar në nenin 3.1(b);

b) Në rastin e parashikuar në nenin 3.1(c), të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të ndonjë shume për të cilën Marrësi nuk është i aftë të provojë që është përdorur sipas qëllimit të përcaktuar;

c) Në rastin e parashikuar në nenin 3.1(d), të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të atyre shumave, pagesa e të cilave për Marrësin ose në emër të Marrësit përbën shkelje të ligjit të zbatueshëm.

Neni 4
Kostot dhe detyrimet publike

Marrësi duhet të mbulojë të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike që krijohen jashtë Republikës Federale të Gjermanisë dhe që lidhen me nënshkrimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, si dhe të gjitha kostot e transferimit dhe të konvertimit që lidhen më disbursimin e kontributit financiar.

Neni 5
Deklaratat kontraktuale dhe fuqia e përfaqësimit

5.1 Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe çdo person i emëruar nga ai ose ajo te KfW-ja dhe i autorizuar nga modeli i nënshkrimit të vërtetuar nga ai ose ajo, duhet të përfaqësojnë Marrësin gjatë zbatimit të Marrëveshjes. Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe çdo person i emëruar nga ai ose ajo do të përfaqësojnë Marrësin gjatë zbatimit të Programit. Kompetencat e përfaqësimit nuk do të përfundojnë deri në momentin që është kryer revokimi i tyre nga përfaqësuesi i autorizuar i Marrësit në momentin që ky revokim është marrë nga KfW-ja.

5.2 Shtesat ose amendimet e kësaj Marrëveshjeje dhe çdo njoftim dhe deklaratë e palëve kontraktuese sipas kësaj Marrëveshjeje duhet të bëhen me shkrim. Ministri i Financave dhe Ekonomisë është i autorizuar të nënshkruajë çdo amendim që duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave. Amendimet e kësaj Marrëveshjeje që ndikojnë vetëm në periudhën e disponueshmërisë (neni 2.2) nuk kërkojnë miratim paraprak nga Këshilli i Ministrave. Çdo njoftim ose deklaratë që merret ose ka arritur në adresat e mëposhtme të palëve përkatëse kontraktuese ose në ndonjë adresë tjetër të palës përkatëse kontraktuese, siç i është njoftuar paraprakisht palës tjetër kontraktuese:

Për KfW-në: KfW Postfach 11 11 41 60046 Frankfurt am Main Republika Federale e Gjermanisë Faks: +49 69 7431- 2944	Për marrësin: Republika e Shqipërisë Ministria e Financave dhe Ekonomisë Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3 Tiranë Faks: +355 42 228494

Neni 6
Programi

6.1 Marrësi, në këtë rast i përfaqësuar nga MZP-ja:

a) Do të përgatisë, zbatojë, operojë dhe ruajë përputhshmërinë e Programit me praktikat më të mira financiare dhe inxhinierike, në përputhje me standardet mjedisore dhe sociale dhe kryesisht në përputhje me konceptimin e Programit, siç është rënë dakord ndërmjet MZP-së dhe KfW-së;

b) Do të caktojë inxhinier këshillues të kualifikuar dhe të pavarur për përgatitjen dhe mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, si dhe një firmë të kualifikuar për zbatimin e Programit;

c) Do të lidhë kontrata për mallrat dhe shërbimet e financuara nga kontributi financiar pasi të jenë kryer procedurat konkurruese ndërkombëtare të ofertimit;

d) Do të garantojë financimin e plotë të Programit dhe me kërkesën e KfW-së, do t'i dërgojë KfW-së të dhëna që provojnë se janë mbuluar kostot që nuk janë paguar nëpërmjet kontributit financiar;

e) Do të ruajë ose do të marrë masa për mbajtjen e librave dhe dokumenteve që tregojnë haptazi të gjitha kostot e mallrave dhe shërbimeve që nevojiten për Programin, duke treguar qartë mallrat dhe

shërbimet e financuara nga ky kontribut financiar;

f) Do t'u mundësojë përfaqësuesve të KfW-së që në çdo kohë të inspektojnë këta libra dhe dokumente dhe secilin ose të gjitha dokumentet e tjera që lidhen më zbatimin dhe operimin e Programit, si dhe të vizitojnë Programin dhe të gjitha instalimet e lidhura më të;

g) Me kërkesë të KfW-së, do të dërgojë pranë KfW-së, duke i dërguar një kopje edhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ndonjë ose të gjithë informacionin dhe raportet mbi Programin dhe progresin e tij; dhe

h) Me nismën e vet, do të informojë në kohë KfW-në për secilën ose të gjitha situatat që parandalojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e Programit.

6.2 MZP-ja dhe KfW-ja do të përcaktojnë detajet që lidhen me nenin 6.1 në Marrëveshjen e Veçantë, e cila do të miratohet nga Marrësi i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

6.3 Për transportin e mallrave dhe shërbimeve të financuara nga kontributi financiar do të zbatohen dispozitat e Marrëveshjes Qeveritare, të cilat janë të njohura për Marrësin.

Neni 7

Publikimi dhe transferimi i informacionit të lidhur me Programin

7.1 Për të përmbushur parimet e pranuara ndërkombëtare për transparencë maksimale dhe eficiencë në zhvillim dhe bashkëpunim, KfW-ja publikon informacion të zgjedhur (duke përfshirë raportet e vlerësimit) për Programin dhe mënyrën se si është financuar gjatë negociatave parakontraktuale, ndërsa marrëveshja/t e lidhur/a me Programin janë zbatuar edhe në fazën paskontrakuale (në vijim e referuar si "E gjithë periudha").

Informacioni publikohet rregullisht në faqen e internetit të KfW-së për zonën e tij të biznesit "KfW Development Bank"

(http://transparenz.kfwentwicklungsbank.de/).

Publikimi i informacionit (si nga KfW-ja ose palët e treta në përputhje me nenin 7.3 më poshtë) për Programin dhe mënyrën se si është financuar, nuk do të përfshijë dokumentacion kontraktues ose informacion sensitiv financiar ose të detajuar, në lidhje me biznesin rreth palëve të përfshira në Program ose financimin e tij, të tilla si:

a) Informacion për të dhënat e brendshme financiare;

b) Strategjitë e biznesit;

c) Udhëzime dhe raporte të brendshme të korporatës;

d) Të dhëna personale të personave fizikë;

e) Klasifikimi i brendshëm i KfW-së mbi pozicionin financiar të palëve.

7.2 KfW-ja shpërndan informacion të zgjedhur për Programin dhe mënyrën se si është financuar gjatë të gjithë periudhës me subjektet e përcaktuara më poshtë, veçanërisht për të siguruar transparencë dhe eficiencë:

a) Filialet e KfW-së;

b) Republikën Federale të Gjermanisë dhe institucionet e saj kompetente, autoritetet, institucionet, agjencitë dhe filialet;

c) Organizata të tjera zbatuese të përfshira në bashkëpunimin dypalësh gjerman për zhvillimin, veçanërisht *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH*;

d) Organizata ndërkombëtare të përfshira në grumbullimin e të dhënave statistikore dhe anëtarët e tyre, veçanërisht Organizata për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Bashkëpunimin për Zhvillim (OECD) dhe anëtarët e saj.

7.3 Gjithashtu, Republika Federale e Gjermanisë ka kërkuar nga KfW-ja që të ndajë me të informacion të zgjedhur për Programin dhe mënyrën se si është financuar gjatë të gjithë periudhës me subjektet në vijim, të cilat publikojnë seksionet përkatëse sipas qëllimit:

a) Republika Federale e Gjermanisë për qëllime të Nismës së Transparencës së Ndihmës

Ndërkombëtare
(http://www.bmz.de/de/was_wir_machen/wege/transparenz-fuer-mehr-Wirksamkeit/index.html);
b) Tregto dhe Investo në Gjermani (GTAI) për qëllime të informacionit të tregut (http://www.gtai.de/GTAI/Navigation/DE/trade.FOO);
c) OECD-ja për qëllime të raportimit të flukseve financiare në kuadër të bashkëpunimit për zhvillim (http://stats.oecd.org/);
d) Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (DEval) për qëllime të vlerësimit të të gjithë bashkëpunimit gjerman në kuadër të zhvillimit për të siguruar transparencë dhe eficiencë (http://www.deval.org/de/).

7.4 Më tej, KfW-ja ruan të drejtën të transferojë te palët e treta, për sa kohë janë ruajtur interesat e ligjshëm (dhe për qëllime publikimi) informacion për Programin dhe mënyrën se si është financuar gjatë të gjithë periudhës.

Informacioni nuk transferohet nga KfW-ja te palët e treta, nëse interesat e ligjshëm të Marrësit mbi informacionin që nuk do të transferohet nuk balancojnë interesat e KfW-së, nëse transferohet. Interesat e ligjshëm të Marrësit përfshijnë konfidencialitetin e informacionit sensitiv të përcaktuar në nenin 7.1, i cili është i përjashtuar nga publikimi.

Gjithashtu, KfW-ja ka të drejtë të transferojë informacionin te palët e treta, nëse kjo është e nevojshme për shkak të kërkesave rregullatore ose statutore ose për të pohuar, ose për të mbrojtur ndaj ankesave, ose çdo të drejtë tjetër ligjore para gjykatës ose procedurave administrative.

Neni 8

Dispozita të ndryshme

8.1 Marrësi, nëpërmjet MZP-së, do të garantojë që personat e ngarkuar prej tij për përgatitjen dhe zbatimin e Programit, lidhjen e kontratës për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve që do të financohen dhe që kërkojnë disbursimin e shumave të kontributit financiar nuk do të kërkojnë, pretendojnë, pranojnë, premtojnë ose marrin një premtim për pagesa të paligjshme ose avantazhe të tjera që lidhen me detyrat që kanë.

8.2 Marrësi, nëpërmjet MZP-së, nuk do të kryejë transaksione ose angazhohet në aktivitete të tjera që lidhen me Programin, të cilat do të përbënin shkelje të embargove që rregullojnë tregtinë ndërkombëtare ose të ashtuquajturat sanksione financiare të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Bashkimit Evropian ose Republikës Federale të Gjermanisë.

8.3 Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera do të mbeten të pacenuara. Çdo boshllëk që do të shkaktohej nga ky fakt do të plotësohet nga dispozita që janë në përputhje me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

8.4 Marrësi nuk duhet të caktojë ose transferojë, të lërë peng ose si garanci çdo të drejtë të lindur nga kjo Marrëveshje.

8.5 Për këtë Marrëveshje do të zbatohet ligji i Republikës Federale të Gjermanisë. Vendi i ekzekutimit do të jetë Frankfurt am Main.

8.6 Marrëdhëniet ligjore të vendosura nga kjo Marrëveshje ndërmjet KfW-së dhe Marrësit do të përfundojnë në fund të kohëzgjatjes së Programit, por jo më vonë se 15 vjet pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

8.7 Kjo Marrëveshje Financiare do të hyjë në fuqi sapo të jenë përmbushur kushtet në vijim: i. KfW-ja ka marrë njoftimin me shkrim nga Marrësi se procedurat e brendshme ligjore për t'u përmbushur nga Marrësi kanë përfunduar; dhe ii) Marrëveshja Qeveritare ka hyrë në fuqi dhe efekt të plotë.

Bërë në 2 kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main,
në datën 19 dhjetor 2017
KfW

Tiranë,
në datën 19 dhjetor 2017
Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë